

EVIDENTIM I SITUATËS SË SHËRBIMEVE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

BASHKIA BURREL

STATISTIKA

Numri i personave me aftësi të kufizuara në bashkinë Burrel është 1381, prej të cilëve, 841 janë të rregjistruar dhe përfitojnë nga pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar në Bashkinë Burrel, ndërsa 540, janë përfitues nga skemat e Sigurimeve Shoqërore për invalidët e punës.

Mazhoranca e përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar janë meshkuj (n=975; 71%).

24% (n=203) e përfituesve nga skemat e pagesave të mbrojtjes sociale për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Burrelit, janë fëmijë të moshës 0-18 vjeç.

89 persona me aftësi të kufizuara janë edhe përfitues të pagesës së kujdestarisë, 43 prej tyre fëmijë.

SHËRBIMET E OFRUARA NË BASHKINË BURREL

Qendra Ditore për Personat me Aftësi të Kufizuara "Shpresa e Re"

Në territorin e Bashkisë Burrel ushtron aktivitetin vetëm një qendër ditore për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, e cila mbështetet dhe funksionon në ambientet e vëna në dispozicion nga Bashkia Burrel. Qendra ofron shërbim ditor për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara. Qendra mbështetet me fonde nga donatorë, ndërsa Bashkia Burrel, ka ofruar ambientet, por ndihmon edhe në organizimin e aktiviteteve të ndryshme. 38 klientë me aftësi të kufizuara marrin shërbim në këtë qendër, prej të cilëve 20 janë fëmijë. Qendra Ditore ofron këto shërbime: pedagogji, mbështetje psiko sociale, pavarësi praktike, fizioterapi, ergoterapi, shërbim ushqimor, shërbim sanitar. Stafit është i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjitha nevojat e klientëve. Aktualisht kemi punonjës social, psikolog, sociolog, infermjere, mësues mbështetës, terapist zhvillimi, edukatorë. Përfituesit janë kryesisht me aftësi të kufizuara mendore. Qendra ka nevojë për logopedist, fizioterapist dhe ergoterapist. Kërkesat për të marrë shërbime në qendër janë më të mëdha se mundësitë reale të qendrës.

NEVOJA PËR SHËRBIME

Vetëm 38 persona (2.7%), nga 1381 persona me aftësi të kufizuara të identifikuar e vlerësuar nga KMCAP, marrin shërbime nga qendrat që veprojnë në territor.

Mungojnë disa nga shërbimet e parashikuara në shportën e shërbimeve, dedikuar personave me aftësi të kufizuara, përmendur këtu:

- a** shërbimet parashoqërore (informim dhe këshillim, ndërhyrje e hershme, këshillim për punësim, këshillim me telefon);
- b** shërbimet në familje (shërbimi në shtëpi, shërbimi i ndihmësit personal, transporti i aksesueshëm);
- c** shërbimet në komunitet (mbështetje psiko-sociale, qendër komunitare, qendër ditore), shërbime të cilat aktualisht ofrohen në numër të kufizuar nga organizatat;
- d** shërbime të specializuara (shërbime zhvilluese e rehabilituese)
- e** shërbime të punësimit me mbështetje; etj.

Shërbimet komunitare duhet të shtohen në numër, por edhe në llojshmëri, me qëllim që t'i vijë në ndihmë të gjithë individëve me aftësi të kufizuara në nevojë, në territorin e Bashkisë Burrel.

